



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KORPORATA ELEKTROENERGJITIKO SHQIPTARE

RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS


Baza ligjore

VKM Nr. 686, date: 29.7.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore"

Ligji nr. 10440, date: 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"

PROJEKTI

**“REHABILITIMI I GALERISË SË PJERRËT NE HEC KOMAN F.V DEKOVILI
I RI DHE RIKONSTRUKSION I SHESHIT MES GALERISË SË PJERRËT DHE
SHPATIT TË DJATHTË NË DIGËN E KOMANIT”**



“KLODIODA” sh.p.k

SHKURT 2022

Permbajtja

1.Hyrje	3
1.1 Te Pergjithshme.....	3
1.2 Pershkrim i Shkurter i Projektit	4
1.3 Kuadri Ligjor.....	5
2.Pershkrimi i projektit	10
2.1 Pozicioni i Objektivit	10
2.2 Gjendja Ekzistuese e Projektit	10
2.2 Zgjidhja e Projektit.....	13
3.Pershkrimi i Pergjithshem i Peisazhit Natyror	19
3.1Terreni dhe Peisazhi	19
3.2Klima	19
3.3 Relievi, Gjeologjia dhe Toka	27
3.4 Hidrologjia, Ujrat Siperfaqesore dhe Nentokesore	29
3.5 Habitati dhe Biodiversiteti.....	30
3.6 Cilesia e Ajrit	32
3.7 Zhurmat	32
3.8 Komuniteti Lokal dhe çeshtjet Social-Ekonomike	32
4.Ndikimet e projektit ne mjedis dhe masat	34
4.1 Peisazhi	34
4.2 Gjeologjia dhe dherat	34
4.3 Ndikimi ne hidrologji, ujra siperfaqesore dhe nentokesore.....	34
4.4 Ndikimi ne bodiversitet Flora dhe Fauna	36
4.5 Ndikime ne Cilesine e Ajrit	37
4.6 Zhurmat dhe vibrimet.....	38
4.7 Mbetjet.....	38
5 . Kohezgjatja e ndikimeve ne Mjedis	40
5.1 Kohezgjatja dhe Distancat e Ndikimeve	40
5.2Menaxhimi dhe Monitorimi i Mjedisit	41
6.Ndikimet e Mundshme ne Mjedisin Nderkufitar	42

1.Hyrje

1.1 Te Pergjithshme

Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) është një proces i cili kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis si pasojë e zbatimit të projekteve të propozuara publike dhe private. Përmes këtij procesi bëhet e mundur evidentimi, parashikimi dhe vlerësimi i efekteve gjatë dhe pas zbatimit të projektit mbi biodiversitetin, burimet ujore, trupat ujorë, ndikimet në cilësinë e mjedisit (zhurmat, cilësia e ajrit), ndikimet në terren, peisazhin si dhe ndikimin e tërësisë së këtyre faktorëve mbi trashëgiminë kulturore, njerëzit, shëndetin publik si dhe në aspektin ekonomik. VNM-ja mundëson parandalimin e efekteve negative, i jep përparësi ndikimeve pozitive duke mos lejuar dhe duke shmangur që në etapat e para të zbatimit ndikimet negative. Në procesin e VNM marrin pjesë zhvilluesi i projektit së bashku me grupin e tij të specialistëve, specialistët e mjedisit, ministria dhe strukturat e saj të varësisë, njëësia e qeverisjes vendore në territorin e të cilës zbatohet projekti, grupet e interesit dhe palët e interesuara, publiku dhe organizatat jofitimprurëse përmes ankesave dhe seancave dëgjimore, institucionet që në bazë të ligjit kanë përgjegjësi të përfshihen në procesin e VNM-së si dhe në rastet kur projekti ka kontekst ndërkufitar zbatohen kërkesat sipas Konventës së ESPOO-s.

Mbrojtja e mjedisit në Shqipëri është sanksionuar me të parin institucion shtetëror për mbrojtjen e mjedisit, me Komitetin për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit, pranë Këshillit të Ministrave. Në vitin 1992, ky institucion u bashkua me Ministrinë e Shëndetësisë, duke krijuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe vitin 1998 u krijua Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe në vitin 2001 Ministrinë e Mjedisit

Në vitin 2005, kjo ministri u fuqizua më tej, duke u shndërruar në Ministri të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU).

Ne vitin 2013 MMPAU u riemertua perseri MM ne varesi te te ciles eshte edhe Agjencia Kombetare e Mjedisit.

Ministria Turizimit dhe Mjedisit (MTM), eshte autoriteti kryesor pergjegjes per menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe hartimin e politikave mjedisore ne nivel kombetar. Ministria e Mjedisit u krijua si organi shtetëror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politiken e qeverise për mbrojtjen emjedisit, harton projekt-akte ligjore e nen-ligjore ne fuksnion te mbrojties dhe menaxhimit te qendrueshem te mjedisit, bashkerendon aktivitetet e institucioneve te linjes per ceshtje te mjedisit. Ministria Turizmit dhe Mjedisit ka pergjegjesi totale per mbrojtjen e mjedisit, specifikisht per ajrin, mbetjet, kimikatet, ndryshimet klimatike si edhe te pyjeve, zonave te mbrojtura dhe biodiversitetit. Ministria eshte pergjegjese per miratimin e vleresimeve strategjike mjedisore per çdo plan territorial ose sektorial te miratuar sipas ligjit per planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Parimet bazë të politikës për mbrojtjen e mjedisit u sanksionuan për herë të parë në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” (1993), të amenduar në vitin 1998 dhe së fundi në vitin 2008. Në vitin 2011 u aprovua Ligji Nr. 10431 "Për mbrojtjen e mjedisit" date 09/06/2011.

Në vitin 1998, u miratua gjithashtu Kushtetuta e re e Republikës së Shqipërisë. Neni 59 i saj thekson se në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe mjeteve në dispozicion dhe në mënyrë që të realizojë iniciativën dhe përgjegjësitë private, shteti synon të sigurojë një mjedis ekologjikisht të shëndetshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm si dhe përdorimin racional të pyjeve, ujrave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore në bazë të parimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Një rëndësi e vecantë i kushtohet përafrimit të legjislacionit mjedisor me atë të Bashkimit Europian dhe zbatimit të standardeve mjedisore.

Ky studim merr parasysh të gjitha kërkesat e Akteve Ligjore Mjedisore në Shqipëri.

1.2 Pershkrim i Shkurter i Projektit

Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare ka planifikuar:

**" REHABILITIMI I GALERISË SË PJERRËT NE HEC KOMAN F.V DEKOVILL I RI DHE
RIKONSTRUKSION I SHESHIT MES GALERISË SË PJERRËT DHE SHPATIT TË
DJATHTË NË DIGËN E KOMANIT”**

Diga e HEC Koman me lartësi 115.5 m është diga e dyte me e lartë në vendin tone. Bazuar në analizen e riskut për digat e kaskades së lumit Drin sipas rekomandimeve të ICOLD, kjo diga klasifikohet si diga e klasit të parë. Diga është përfunduar në vitin 1985 si rrjedhojë e të cilës është krijuar liqeni i Komanit me vëllim të projektuar prej afro 500 milion m³. Niveli i kurorës së digës është 185.00 mmnd.

Objektet kryesore të kësaj dige përfaqësohen nga trupi i digës (mbushje me gurë), ekrani beton-arme, dy tunelet e devijimit, dy tunelet e shkarkimit, dy tunelet e marrjes që ndahen në katër tunele në zonën e kullave të ekuilibrit, tunelet ndihmëse etj.

Zona ku është ndërtuar diga e Komanit përfaqësohet nga një zonë me probleme të vështira gjeologjike dhe hidrogeologjike, me çarje të shpateve në të dy anët e digës, paqëndrueshmëri të tyre dhe tendencë për shpëputje të masivëve shkëmborë dhe rënie të tyre në pjesët e poshtme të shpateve. Shpatet ku janë vendosur veprat e kësaj nyje hidroenergjetike janë me pjerrësi të madhe dhe me zona me paqëndrueshmëri të masivëve shkëmbore.

Objekte në të cilat kërkohet rehabilitimi i plote i tyre pjesë e hidrocentralit Koman janë:

- a) Galeria e Pjerret (çimentimit dhe kontrollit)
- b) Sheshi midis Galerisë së Pjerret dhe shpatit të djathtë të HEC Koman.

Ndertimi i galerive të çimentimit dhe kontrollit u realizuar në vitin 1984. Kjo galeri shërben për kontroll-monitorimin e perdes së thelle të çimentimit dhe në të janë instaluar paisjet e kontrollit të ekranit betonarme të diges. Paisjet janë vendosur në pjesë të ndryshme të galerisë së pjerret (çimentimit dhe kontrollit). Në fund të Galerisë, në pjesën horizontale të saj, në anën e djathtë të tyre, ndodhen pompat e drenazheve që shërbejnë për largimet e ujrave të filtruara të cilat kontrollohen dhe monitorohen vazhdimisht. Ajo është një strukturë beton-arme e vendosur mbi digën e HEC Koman dhe ka një formë rrethore me diametër të brendshëm 4.5m. Në planin horizontal Galeria në distancë 59m nga fillimi i saj ka një këthesë prej 32 grade në drejtim të lindjes. Në planin vertikal, galeria në pjesën e parë me një gjatësi prej 55m ka një pjerresë në rnie prej 31 grade, ndërsa në pjesën tjetër pjerresia vazhdon me 26 grade.

Sheshi midis Galerisë së pjerret dhe shpatit të dhjathtë të Diges së HEC Koman shfrytëzohet nga Reparti Hidroteknik për punime mirëmbajtjeje dhe pastrimi të hidrocentralit. Ky shesh dikur ka qenë i asfaltuar. Shtresat asfaltike dhe e tere paketa e shtresave ka degraduar pothuaj tërësisht. Mirëmbajtja e dhe pastrimi i ujit në dige bëhet gati i pamundur për shkak se paisjet e rënda si vinca nuk mund të kryejnë punën për shkak se hapësirat e sheshit janë të ngushta. Risistemimi i sheshit do të bëjë të aksesueshme paisjet e tilla që të bëhet pastrimi i mbetjeve që grumbullohen në ujën.

1.3 Kuadri Ligjor

Legjislacioni që drejton mbrojtjen e mjedisit është fuqizuar relativisht me shpejtësi në Shqipëri. Me daljen e Ligjit Nr. 10431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i datës 09/06/2011 u shfuqizua Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

Ligji Nr. 10431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i datës 09/06/2011 përcakton së mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Neni 28 kërkon që veprimtaritë, që shkaktojnë ndotje në mjedis, pajisen me lejen përkatëse të mjedisit, ku përcaktohen, me shkrim, kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Për sa i përket Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në Ligjin Nr. 10431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i datës 09/06/2011 në Nenin 25 thuhet se:

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.
2. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujën, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin

natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.
4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis” synon që të sigurojë:

1. një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis kërkon që informacionet e mëposhtme të përfshihen në VNM:

Neni 4

Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj.

Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

2. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Neni 10

Paraqitja e kërkesës për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga zhvilluesi

Zhvilluesi për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë QKL-së, përveç dokumentacionit të kërkuar sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, edhe dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë:

- a) Për projektet e shtojcës II:
 - raportin paraprak të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit;
 - projektin teknik të veprimtarisë;
 - faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.

- b) Për projektet e shtojcës I:
 - raportin e thelluar të VNM-së, të hartuar sipas llojit të projektit;
 - përmbledhjen jotechnike të raportit të VNM-së;
 - projektin teknik të veprimtarisë;
 - informacion për informimin dhe konsultimin me publikun;
 - faturën e pagesës së tarifës së shërbimit, sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji.

BAZA LIGJORE

Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”,

Ligji nr.10440 date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” si dhe Ligjin Nr 12, date 26.02.2015 “Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 10440 date 7 7 2011”.

Ligji nr.10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”.

Ligji nr.8897, date 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", amenduar me ligjin Nr.10 266, datë 15.4.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8897, datë 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"

Ligji Nr. 111/2012 ”Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”,

Ligji Nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”,

Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit “, amenduar me Ligjin Nr. 37\2013 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006 ”per Mbrojtjen e biodiversitetit” dhe ligjin Nr. 68/2014 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar,

Ligji Nr. 8906 i dates 06.06.2002, “per Zonat e Mbrojtura” , (i amenduar me Ligjin nr. 9868, date 4.02.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8906, date 6.06.2002 “Per zonat e mbrojtura”),

Ligj Nr. 10463, date 22.09.2011, “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”,

Ligji Nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”,

Ligji nr.9108, date17.07.2003 “Per substancat dhe preparatet kimike”,

Ligji Nr.10119, datë 23.04.2009. “Per planifikimin e territorit”,

Ligji Nr.9048, date 7.4.2003 “Per trashëgimine kulturore” amenduar me: Ligjin nr.9592, datë 27.07.2006;

Ligjin nr.9882, datë 28.02.2008; Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009,

Ligji nr.9115, date 24.07.2003 “Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotura”.

VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

VKM Nr.912 ,date 11.11.2015, "Per miratimin e metodologjise kombetare te procesit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis””.

VKM Nr.575,date 24.06.2015, "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte".

VKM Nr. 628, date 15.07.2015, "Per miratimin e rregullave teknike te projektimit dhe ndertimit te rrugeve"

VKM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

VKM Nr.676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare

VKM Nr. 177, date 31.03.2005 “ Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese,

VKM Nr. 502, date 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit” i ndryshuar me: - VKM Nr.88, datë 07.02.2012 - VKM Nr. 139, datë 22.02.2012 - VKM Nr. 345, datë 09.05.2012 - VKM Nr. 314, datë 13.3.2013 - VKM Nr. 488, date 14.06.2013,

VKM Nr.435, date 12.09.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer”.

VKM Nr. 103, date 31.03.2002 “Per Monitorimin Mjedisor ne Republiken e Shqiperise:”

Udhëzim Nr.6527 datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre”

Udhëzim Nr.8 datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”

Rregullore Nr.1 datë 15.03.2006 “Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore”

Urdher Nr.1280 dt.20.11.2013, “Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes se eger”

2.Pershkrimi i projektit

2.1 Pozicioni i Objektivit

Zona ku eshte ndertuar HEC Koman, sipas klasifikimit gjeografik të vendit tonë,ben pjese në Krahinën Krahinën e Alpeve Shqiptare (pjesa jugore e saj). I tere segmenti shtrihet ne nje terren malor dhe te zhveshur.

Koordinatat Gjeografike brenda te cilave shtrihet objekti jane:

Gjeresi Gjeografike 42° 06' 00'' - 42° 07' 00''

Gjatesi Gjeografike 19° 49' 00'' - 19° 50' 00''

Koordinatat shteterore brenda te cilave shtrihet objekti jane:

Gjeresi 46 63 450 – 46 64 550m

Gjatesi 44 02 020 – 44 03 020m

2.2 Gjendja Ekzistuese e Projektit

HEC Koman në veri të Shqipërisë i ndertuar në lumin Drin ka filluar punen në vitin 1985. Ndertesa e Çentralit te HEC Koman ndodhet në bregun e djathte te rrjedhes, pranë fundit të digës se Komanit. Gjithashtu ne krahun e djathte te biefit te siperm te diges se Komanit ndodhet Vepra e marrjes se ujit dhe Hyrja e tuelit Nr.4 te shkarkimit.

Shkarkuesit e HEC Koman përbëhen nga dy tunele të veshur me beton të cilet ndodhen ne bregun e djathtë dhe te majte te lumit Drin. Këto dy tunele, të përcaktuara si tuneli i shkarkimit Nr.3 dhe Nr.4, kanë karakteristika të përgjithshme shumë të ngjashme sic jane vepra e marrjes në formen e kullës betonarme ku jane janë vendosur portat radiale të punës dhe portat e mirmbajtjes. Sistemi i portave është i njëjtë për të dy tunelet e shkarkimit.

Vepra e marrjes së ujit në tunelin e shkarkimit Nr.3 është e aksesueshme nga kurora e digës përmes një urë të varur metalike ndërsa vepra e marrjes së ujit në tunelin e shkarkimit Nr.4 është e aksesueshme përmes tunelit qe ndodhet ne anen e djathte te kurores se diges. Prane portave te hyrjes te tunelit te shkarkimit Nr.4 ndodhen edhe portat e vepres se marrjes se ujit per Turbinat e HEC Koman.

a) Galeria e Pjerret (çimentimit dhe kontrollit)

Siç e permendem edhe me lart, kjo galeri eshte ndertuar ne vitin 1984. Ajo eshte nje strukture betoname e vendosur mbi digen e HEC Koman dhe ka nje forme rrethore me Diameter te brendshem 4.5m.

Galeria ka nje gjatesi prej 250m (ne plan) nga te cilat 232 jane ne pjesen e pjerret te saj dhe 18m ne pjesen horizontale te saj.

Ne planin horizontal Galeria ne distance 59m nga fillimi i saj ka nje kthese prej 32 grade ne drejtim te lindjes.

Ne planin vertikal, galeria ne pjesen e pare me nje gjatesi prej 55m ka nje pjerresi ne renie prej 31 grade, ndersa ne pjesen tjeter pjerresia vazhdon me 26 grade.

Galeria ka nje organizim te tille:

Ne qender te saj eshte pozicionuar nje kanal per kullimin dhe largimin e ujrave me thellesi mesatare 45cm dhe gjeresi 50cm.

Ne te dy anet e kanalit jane ndertuar simetrikisht shkallare me gjeresi 1m, per levizjen e kembesoreve pergjate galerise.

Ne dy anet e shkallareve jane ndertuar dy platforma te pjerreta betoni mbi te cilat jane vendosur shinat e dekovilit ekzistues.


Ne dy faqet e galerise jane vendosur kablllo qe lidhin fundin e galerise (zonen e kontrollit me pjeset e tjera te HEC Koman.

Ne faqen e majte te Galerise eshte vendosur sistemi i ndricimit. Sistemi i ndricimit eshte realizuar me ndricues neoni tubolar 2x36w. Ndricimi eshte i amortizuar dhe demtuar ne disa zone, duke krijuar zona te erreta pergjate galerise. Per me teper ky sistem konsiderohet i vjeter dhe jo eficient. Demtime te sistemit te ndricimit verehen si ne ndricues ashtu edhe ne elementet e rrjetit (tuba, percjelles, kuti shperndarese, grapeta etj).

Ne hyrje te Galerise jane vendosur paisjet e komandimit dhe funksionimit te Dekovilit ekzistues si dhe nje dhome komandimi dhe kontrolli.

Ne pjesen fundore te Galerise, ate horizontale jane vendosur pompat e largimit te ujrave dhe nje dhome ku jane montuar paisjet e monitorimit dhe Kontrollit.





b) Sheshi midis Galerise se pjerret dhe shpatit te dhjathte te Diges se HEC Koman

Ky shesh shfrytezohet nga Reparti Hidroteknik per punime mirembajtjeje dhe pastrimi te hidrocentralit. Ne ane te diges akumulohen mbeturina te shumta urbane dhe pyjore, te cilat vijne nga perrenjte malore te pellgut ujembledhes te Liqenit te Komanit. Mbeturinat akumulohen ne skarpaten e diges. Rehabilitimi i ketij sheshi me qellim krijimin e nje hapsire pune per vincin do beje te mundur evadimin e mbeturinave nga Liqeni i Komanit.

Ky shesh dikur ka qene i asfaltuar. Shtresat asfaltike dhe e tere paketa e shtresave ka degraduar pothuaj teresisht.

Ne hyrje te sheshit, ne anen e djathte eshte Godina e hyrjes se Galerise se Pjerret. Ndersa ne anen e majte eshte ndertuar nje mur prites, i cili sherben per pritjen e materialeve inerte qe shkeputen nga faja e shpatit te diges. Te dy keta elemente krijojne nje hinke te ngushte ne hyrje te sheshit.

Aktualisht hyrja e vincit per shkak te permasave te tij, ne kete shesh eshte i pamundur dhe pastrimi i liqenit behet nga kreshta e Diges se Komanit, gje e cila per shkak te distances behet me shume veshitresi.



2.2 Zgjidhja e Projektit

Qëllimi dhe Objektivat e Ndrehyrjes

Galeria e Pjerret dhe Sheshi ne krah te saj jane pjese integrale e HEC KOMAN. Qellimi dhe objektivi i kesaj Kontrate eshte realizimi i nje projekti zbatimi, i cili ka synim permiresimin e infrastruktures operuese ne galerine e monitorimit dhe te shehsit ne ane te saj.

Realizimi dhe zbatimi i ketij projekti, do te kete objektiv permiresimin e kushteve teknike edhe rritjen e sigurise gjate operimit si dhe rritjen e jetegjatesise se vepres ne teresine e saj.

Ky projekt do te beje te mundur reabilitimin e sheshit ne krah te galerise duke e bere ate funksional dhe eficient.

Gjithashtu ky projekt synon rehabilitimin e Galerise se pjerret ne teresi si dhe montimin brenda saj, te nje Dekovili te Ri

Masat e nderhyrjes te projektit ne secilen nga objektet te cilat perfshihen ne kete kontrate, masat nderhyrese rikonstruktive sipas rasteve, paraqiten si ne vijim:

a) Galeria e Pjerret

Galeria e Çimentimit dhe Kontollit eshte e ndertuar ndertuar ne vitin 1984. Konturi i Galerise eshte nje strukture betoname e vendosur mbi digen e HEC Koman dhe ka nje forme rrethore me Diameter te brendshem 4.5m.

Galeria ka nje gjatesi prej 250m (ne plan) nga te cilat 232 jane ne pjesen e pjerret te saj dhe 18m ne pjesen horizontale te saj.

Ne planin horizontal Galeria ne distance 59m nga fillimi i saj ka nje kthese prej 32 grade ne drejtim te lindjes.

Ne planin vertikal, galeria ne pjesen e pare me nje gjatesi prej 55m ka nje pjerresi ne renie prej 31 grade, ndersa ne pjesen tjeter pjerresia vazhdon me 26 grade.

Galeria ka nje organizim te tille:

Ne qender te saj eshte pozicionuar nje kanal per kullimin dhe largimin e ujrave me thellesi mesatare 45cm dhe gjeresi 50cm.

Ne te dy anet e kanalit jane ndertuar simetrikisht shkallare me gjeresi 1m, per levizjen e kembesoreve pergjate galerise.

Ne dy anet e shkallareve jane ndertuar dy platforma te pjerreta betoni mbi te cilat jane vendosur shinat e dekovilit ekzistues.

Ne dy faqet e galerise jane vendosur kablllo qe lidhin fundin e galerise (zonen e kontrollit me pjeset e tjera te HEC Koman.

Ne faqen e majte te Galerise eshte vendosur sistemi i ndricimit. Sistemi i ndricimit eshte realizuar me ndricues neoni tubolar 2x36w. Ndricimi eshte i amortizuar dhe demtuar ne disa zone, duke krijuar zona te erreta pergjate galerise. Per me teper ky sistem konsiderohet i vjeter dhe jo eficient. Demtime te sistemit te ndricimit verehen si ne ndricues ashtu edhe ne elementet e rrjetit (tuba, percjelles, kuti shperndarese, grapeta etj).

Ne hyrje te Galerise jane vendosur paisjet e komandimit dhe funksionimit te Dekovilit ekzistues si dhe nje dhome komandimi dhe kontrolli.

Ne pjesen fundore te Galerise, ate horizontale jane vendosur pompat e largimit te ujrave dhe nje dhome ku jane montuar paisjet e monitorimit dhe Kontollit.

Per rehabilitimin e galerise do te behen keto nderhyrje sipas kesaj rradhe pune:

- Do te cmontohen dhe hiqen te tera mekanizmat dhe paisjet e dekovilit te vjeter dhe do te largohen nga objekti (ne piken e caktuar nga KESH)
- Do te cmontohen dhe hiqen te shinat qe kane sherbyer per levizjen e dekovilit te vjeter dhe do te largohen nga objekti (ne piken e caktuar nga KESH)
- Do te prishen te dy bankinat anesore prej betoni ku jane montuar shinat (shtresa e bere per nivelim)
- Do te behet prishja pjesore e shkalleve. Do te prishen ato shkalle qe kane demtime strukture (si plasaritje, shkeputje etj)
- Do te behet pastrimi i kanalit nga mbeturinat dhe pastrimi i siperfaqes se betonit.
- Do te cmontohen tere kabllot e trasmetimit dhe furnizimit qe ndodhen ne anen e djathte te galerise.
- Do te behet pastrimi (zmerilimi) e siperfaqes se betonit (gjysma e djathte e galerise. Me ane te zmerilimit do te pastrohen tere mbetjet nga armatura e betonit. Gjithashtu do te priten tere kunjat e dala te hekurit te lena nga ndertimi.
- Do te behet montimi i linjave te reja te ndricimit te galerise.
- Do te behet montimi i kabllovet e trasmetimit dhe furnizimit.
- Do te cmontohen tere kabllot e trasmetimit dhe furnizimit qe ndodhen ne anen e majte te galerise dhe do te montohen ne anen e djathte te galerise.
- Do te behet cmontimi i ndricimit ekzistues, i cili ndodhet ne anen e majte te galerise.
- Do te behet pastrimi (zmerilimi) e siperfaqes se betonit (gjysma e majte e galerise). Me ane te zmerilimit do te pastrohen tere mbetjet nga armatura e betonit. Gjithashtu do te priten tere kunjat e dala te hekurit te lena nga ndertimi.
- Do te behet prishja e suvave ekzistuese ne sallen e montimit te makinerise se dekovilit dhe ne sallen e komandimit.
- Do te behet veshja e bazes se kanalit me nje shtrese betoni C25/30 me spesor 5cm. Siperfaqja do behet e lemuar. Shkallet e betonit do te vishen me nje shtrese betoni C25/30 me trashesi 5cm. Shkallet do te armohen me nje zgare hekur 10mm (sipas detajit perkates) Per lidhje do te inkastrihen fitila hekuri 12mm respektivisht dy cope per cdo shkalle. Siperfaqja e shkalleve do te realizohet e ashper per te shmangur rreshkitjen gjate levizjes (I ashtuquajtur beton me fshese).
- Do te behet montimi i bazamenteve per mbajtjen e shinave te reja te dekovilit.
- Me pas do te behet pastrimi me fshese me aspirim dhe lyrja me boje betoni ngjyre gri e hapur.
- Do te behet montimi i ndricuesve te galerise dhe venia ne pune e sistemit te ndricimit.
- Do te montohen shinat e reja te dekovilit.

- Do te vendoset korimano metalike pergjate galerise. Korimano do te vendoset ne anen e djathte te kanalit duke sherbyer njekohesiht si per mbajtjen e personave gjate ngjitje-zbritjes neper shkalle ashtu edhe si nje barriere mbrojtese midis pjese se levizjes se kembesoreve dhe pjeses ku leviz dekovili.
- Do te lihen disa hapsira 1.5-2m ne zonat ku parashikohet te kete ndalesa te dekovilit (stacione).
- Dhoma e montimit te mekanizmave te dekovilit do te shtrihet me beton C25/30 me t=8-10cm e perforuar me hekur 10mm ne forme zgare 10x10cm.
- Do behet montimi i mekanizmave dhe paisjeve te dekovilit te ri.
- Do te behet montimi i paneleve elektrike.
- Do behet lysterja e sallave me boje hidromat.
- Do te behet testimi, kolaudimi dhe venia ne pune e dekovilit.

Dekovili i ri do te kete keto parametra kryesore:

Funksionim ne pjerresi – per kushte te veshtira Industrial

Aftesi mbajttese (transportuese) totale 1850kg

Fuqia e motorit 11.2-15kW trefazor me 50HZ.

Kabine e hapur me kater poste uljeje me lartesi 1.07m

Permasa te jashtme te kabines 1.7m gjeresi dhe 2.9m gjatesi.

Dyshemeja e kabines rezistente ndaj rreshkitjes.

Gjatesia e levizjes 250m

Shinat e levizjes dhe te gjitha pjeset perberes te dekovilit do te jene material inoks 304L

Shinat do te kene forme “C” nga ana e bredshme per te siguruar levizjen.

Numri i ndalesave – dy

Prodhimi do jete i standartit European ose Amerikan (UNI EN, DIN, BSI)

Seksion terthor i Galerise

Ne anen e majte saj (ne drejtimin zbritje) do te vendoset dekovili i ri. Shinat do te montohen mbi bazamente metalike te fiksuara ne prishaniere ne betonin ekzistues.

Kanali i kullimit te ujrave do te qendroje ne pozicionin aktual duke u riveshur ne baze dhe duke u mbuluar me zgare metalike te zinguar.


Shkallet ekzistuese ne anen e djathte te galerise do te rivishen me betonarme.

Ne anen e majte te kesaj shkalle do te vendoset nje korimano inoksi ose hekuri te zinguar.

Ne faqen anesore te djathte te galerise do te montohen kanalina metalike ne te cilat do te vendosen kabllot e transmetimit te fuqise dhe kabllot e komandimit.

Ne pjene djathtat lart (2.5m-2.7m lartesi) do te vendoset ndricimi i galerise, pergjate gjithe gjatesise se saj.

Seksioni Tip i Galerise



b) Sheshi midis Galerise se pjerret dhe shpatit te dhjathte te Diges se HEC Koman

Ky shesh shfrytezohet nga Reparti Hidroteknik per punime mirembajtjeje dhe pastrimi te hidrocentralit. Ne ane te diges akumulohen mbeturina te shumta urbane dhe pyjore, te cilat vijne nga perrenjte malore te pellgut ujembledhes te Liqenit te Komanit. Mbeturinat akumulohen ne skarpaten e diges. Rehabilitimi i ketij sheshi me qellim krijimin e nje hapsire pune per vincin do beje te mundur evadimin e mbeturinave nga Liqeni i Komanit.

Ky shesh dikur ka qene i asfaltuar. Shtresat asfaltike dhe e tere paketa e shtresave ka degraduar pothuaj teresisht.

Ne hyrje te sheshit, ne anen e djathte eshte Godina e hyrjes se Galerise se Pjerret. Ndersa ne anen e majte eshte ndertuar nje mur prites, i cili sherben per pritjen e materialeve inerte qe shkeputen nga faqja e shpatit te diges. Te dy keta elemente krijojne nje hinke te ngushte ne hyrje te sheshit.

Aktualisht hyrja e vincit per shkak te permasave te tij, ne kete shesh eshte i pamundur dhe pastrimi i liqenit behet nga kreshta e Diges se Komanit, gje e cila per shkak te distances behet me shume veshtiresi.

Per rehabilitimin e sheshit do te behen keto nderhyrje sipas kesaj rradhe pune:

- Do te behet skarifikimi i shtresave ekzistuese rrugore (asfalto-beton, binder stabilizant)
- Do te behet prishja e murit te betonit ne hyrje te sheshit.
- Do te behet ndertimi i murit te ri te betonarmese (ne forme harku me afer shpatit.
- Do behet shtrimi me cakell makinerie i sheshit. Me kete shtrese do te behet nivelimi i pare.
- Do te behet shtrimi me beton C7/10 i sheshit me nje trashesi 10cm. Me kete shtrese do te behet nivelimi perfundimar baza per shtrimin perfundimtar te sheshit.
- Do te behet ndertimi i kanalait te ri ku kalojne linjat e trasmetimit dhe te furnizimit te galerise. Do te behet spostimi i kablllove
- Do te behet vendosja e zgares se hekurt D=12mm ne distance 12x12cm.
- Do te behet betonimi i sheshit me Beton C30/37 me trashesi 20cm. Siperfaqja e betonit do te realizohet me viaska per te shmangur rreshkitjet.

3.Pershkrimi i Pergjithshem i Peisazhit Natyror

3.1 Terreni dhe Peisazhi

Ky seksion merret me mjedisin ne kushtet aktuale. Nje theks i vecante duhet te jepet faktit qe mjedisi ka nje njesi te balancuar mire qe ndikohet shume nga ndyshimet. Mjedisu duket te konsiderohet si teper dinamik dhe vecanerisht i nderprere nga nderhyrja njerezore.


Shqipëria është vendi me numer më të madh digash në Evropë për njësi sipërfaqeje të territorit. Ajo dallohet edhe për nga lartësitë shumë të mëdha të disa digave, që janë ndër më të lartat në kontinent, si diga e Hidrocentralit të Komanit, 164 m e lartë dhe 500 m e gjatë. Digat i përkasin sistemit hidroenergjetik dhe atij të bonifikimit. Jeta e këtyre digave është nga disa vjeçare deri në 50 vjet. Puna normale e tyre dëshmon me së miri për projektim dhe ndërtim cilësor.

Ne aspektin pozitiv terreni malor eshte shume i pershtatshem per zhvillimin e turizmit malor, krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera te medha ekonomike qe gjenden brenda hapësirës gjeografike , kryesisht pyje natyrore, bime mjekesore etj. Nder pyjet natyrore permendim dushku, puishe, ahu. Pjesa tjeter e siperfaqes perbehet nga killota, toke bujqesore dhe troje te tjera. Nder pasurite mbitokesore permenden bimet mjekesore si boronica, shtogu, trumza, lisna, shkema etj. Kerpuha te llojeve te ndryshme.

3.2 Klima

Sipas ndarjes klimatike të vendit tonë zona në studim shtrihet në fillimin e rrugës në nënzonën klimatike bregdetare veriore, ndërsa në pjesën e dytë deri në Koman në nënzonën mesatare kodrinore veriore

ZONAT KLIMATIKE TË SHQIPËRISË



ZONAT DHE NENZONAT KLIMATIKE

- | | |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ul style="list-style-type: none"> I Mesdhetare fushore II Mesdhetare kodrinore III Mesdhetare paramalore IV Mesdhetare malore | <ul style="list-style-type: none"> Ia Mesdhetare fushore veriore Ib Mesdhetare fushore qendrore Ic Mesdhetare fushore jugore IIa Mesdhetare kodrinore veriore IIb Mesdhetare kodrinore qendrore IIc Mesdhetare kodrinore juglindore IIId Mesdhetare kodrinore jugperëndimore IIIa Mesdhetare paramalore veriore IIIb Mesdhetare paramalore jugore IVa Mesdhetare malore veriore IVb Mesdhetare malore lindore IVc Mesdhetare malore juglindore IVd Mesdhetare malore jugore |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|


a) Temperatura ajrit

Temperatura e ajrit është një parametër kryesor klimatik që shërben për të karakterizuar klimën e një vendi apo të një rajoni. Elementet kryesor të temperaturës së ajrit janë regjmi i vlerave mesatare, ecuria ditore mujore dhe vjetore; vlerat ekstreme të saj, që ndikojnë në strukturat ndërtimore urat, veprat e artit, si kombinat, bokset e tjera që ndërtohen në zonën që studiojmë.

Praktikisht duhet të vemi në dukje që zona në studim gjendet nën ndikimin e rrymave detare të detit Adriatik dhe në pjesën më të madhe të vitit, si dhe në ndikimin e rrymave ajrore kontinentale, si rrjedhojë e relievit të ulët në veri të saj dhe luginës së Drinit të Bardhë që janë portat kryesore nga depërtojnë erërat lindore dhe verilindor të cilat vijnë me temperatura negative për zonën në studim u morën vendmatjet meteorologjike Vau-Dejës dhe Fierzë.

Tabela 1. Temperatura mesatare e ajrit mujore e vjetore

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes
Vau-Dejës	6.9	8.3	10.9	14.6	19.0	23.1	25.9	25.8	22.3	17.7	12.8	8.9	16.3
Fierzë	2.1	2.7	7.4	12.3	17.0	19.9	22.3	21.9	18.9	13.2	6.5	3.6	12.3



Shpërndarja brendavjetore e temperaturave të ajrit

Tabela 2. Temperaturat minimale absolute të ajrit

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Më e ulëta
Vau-Dejës	-8.0	-6.9	-4.9	2.2	5.0	10.5	11.6	12.1	8.9	3.1	-1.1	-4.8	-8.0
Fierzë	-19.8	-19.2	-11.7	-4.9	-1.0	3.1	4.3	8.7	1.2	-3.0	-12.2	-16.0	-19.8

Siç shihet nga tabela 2 temperatura minimale arrin deri në -200C në Fierzë. Kjo ndodh për arsye e ardhjes së në periudhën e ftohtë të vitit kemi ardhjen e masave ajrore të ftohta kontinentale nga ana lindore e pellgut ujëmbledhës të lumit Drin i Bardhë në Kosovë.

Vëmë në dukje se matja e temperaturës së ajrit në vendmatje meteorologjike Fierzë ndodhet në kuotën 280 metra mbi nivelin e detit. Po duhet patur parasysh se rrymat ajrore të ftohta që vijnë nga lindja kryqëzohen pikërisht në grykën e Fierzës me rrymat e ngrohta që vijnë nga perëndimi dhe si rrjedhojë buzë liqenit të Komanit kemi një zvogëlim të temperaturës nga Komani në drejtim të Fierzës.

Tabela 3. Temperatura maksimale absolute e ajrit

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Më e larta
Vau-Dejës	18.4	22.2	28.7	28.8	36.2	36.9	39.4	43.6	37.3	32.6	24.6	19.0	43.6
Fierzë	18.4	22.6	25.0	29.4	34.6	35.8	37.9	36.5	35.5	31.5	23.0	21.0	37.9

Muaji më i ftohtë i vitit është janari në Vu-Dejës është 6.90 C ndërsa në Fierzë është 2.10 C. Muaji i nxehtë është korriku 25.90 C dhe 22.30 C.

b) Reshjet atmosferike

Reshjet atmosferike janë një nga parametrat më të rëndësishëm meteorologjikë që përcaktojnë veçoritë klimatike të një zone.


Në projektimin e një rruge veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e sistemit të drenazhimit që lidhen direkt me mbrojtjen e rrugës dhe nga ana tjetër lidhet edhe me kushtet të mjeteve lëvizëse.

Faktorët që ndikojnë në karakteristikat e reshjeve atmosferike janë pozicioni gjeografik, afërsia në detin, orografia. Rruga Koman - Dige siç dihet shtrihet në pjesën veriore të vendit tonë me një reliev kodrinor i rrethuar nga vargmalet e Alpeve veriore që ndahet nga lumi Drin dhe në jug me Krahinën Malore Qendrore (Malësia Pukë – Mirditë) dhe që është korridori i erërave lindore të ftohta kontinentale (Murlani) si dhe erërave perëndimore (Shiroku) që sjellin shira gjatë periudhës së ftohtë të vitit. Pellgu i lumit Drin në këtë zonë karakterizohet me sasi të mëdha reshjesh dhe me rrebeshe me intensitet të konsiderueshme

sidomos zona në studim Vau-Dejës – Koman Dushman. Në tabelën 4 jepen reshjet mujore dhe vjetore të zonës në studim.

Tabela 4. Reshjet mujore dhe vjetore

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
Vau-Dejës	195	168	149	140	104	72	46	71	148	190	230	227	1740
